



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-012

Prishtinë, më 20 dhjetor 2017, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala, Xhavit Haliti, Slavko Simiq dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Fikrim Damka.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se kjo mbledhje e Kryesisë së Kuvendit ishte e thirrur të mbahet ditën e djeshme, por në mungesë të kuorumit është shtyrë për sot.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. Adresimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, z. Hashim Thaçi, deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, ka kërkuar që t'u adresohet deputetëve të Kuvendit të premten, më 22 dhjetor 2017, në orën 13:30.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e Presidentit, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të premten, më 22 dhjetor 2017, në orën 13:30, me këtë:

Rend dite

1. Adresimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, z. Hashim Thaçi, deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Lidhur me pikën e lartcekur diskutuan: Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit, Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së, Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së, Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP të Nismës për Kosovën, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia pas diskutimeve nuk arriti konsensus për caktimin e seancës plenare për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

3. Caktimi i anëtarëve në delegacionin e Kuvendit për Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim, Kosovë - Bashkimi Evropian

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me formimin e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim Asociim, mori këtë:

V E N D I M

I. Caktohet delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin, në këtë përbërje:

1. Memli Krasniqi, GP PDK, Kryetar, Xhavit Haliti, - GP PDK, zëvendësues,
2. Visar Ymeri, GP LVV, Nënkyetar, _____, GP LVV, zëvendësues,
3. Albulena Haxhiu, GP LVV, anëtare, _____, GP LVV, zëvendësues,
4. Donika Kada-Bujupi, GP LVV, anëtare, _____, GP LVV, zëvendësues,
5. Vjosa Osmani, GP LDK, anëtare, Doruntinë Maloku, GP LDK, zëvendësuese,
6. Armend Zemaj, GP LDK, anëtar, Korab Sejdiu, GP LDK, zëvendësues,

7. Arben Gashi, GP LDK, anëtar, Ilir Deda, GP LDK, zëvendësues,
8. Blerta Beliu-Kodra, GP PDK, anëtare, Zenun Pajaziti, GP PDK, zëvendësues,
9. Elmi Reçica, GP PDK, anëtar, Evgjëni Thaçi-Dragusha, GP PDK, zëvendësues,
10. Time Kadrijaj, GP AAK, anëtare, Ahmet Isufi, - GP AAK, zëvendësues,
11. Bilall Sherifi, GP “Nisma për Kosovën”, anëtar; Zafir Berisha, GP “Nisma për Kosovën”, zëvendësues,
12. Adem Hodza, GP Lista serbe, anëtar; Sërgjan Mirtoviq, GP LS, zëvendësues dhe
13. Danush Ademi, GP “6+”, anëtar; Fikrim Damka, GP “6+”, zëvendësues.

4. Caktimi i anëtarëve në delegacionin e përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (SEECP) për Legjislaturën VI

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me emërimin e delegacionit të përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (SEECP) për Legjislaturën e VI, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

I. Emërohet delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Legjislaturën VI në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore, në këtë përbërje:

1. Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryesues i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
2. Komisioni i Përhershëm Qendror, deputeti Zenun Pajaziti GP PDK, anëtar, deputeti _____, zëvendës anëtar nga GP LS,
3. Komisioni për Ekonomi, Infrastrukturë dhe Energjetikë deputeti/ja _____ anëtar, nga GP LDK _____, anëtar/e, _____ deputeti, zëvendës anëtar nga GP AAK,
4. Komisioni për Drejtësi, Punë të Brendshme dhe Bashkëpunim për Siguri, deputeti/ja, _____ anëtar nga GP LVV, deputeti _____, zëvendës anëtar, nga GP “Nisma”,
5. Komisioni për Zhvillim Social, Arsim, Hulimtim dhe Shkencë deputeti/ja _____, anëtar nga GP LVV, deputetja Mufera Shinik, zëvendësues nga GP “6+”.

II. Kërkohet nga grupet parlamentare që t’i propozojnë deputetët për pozitat e lartshënuara.

5. Kërkesa e OJQ “Ballkan Smile”, Prishtinë, për mbështetje financiare

Kryesia, në parim e përkrahu kërkesën e lartshënuar, por meqë ka kaluar afati për pagesë në këtë vit kalendarik, shqyrtimin e saj e shtyu për vitin 2018.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 14:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale